

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Menaxhment Financiar
(Zgjidhjet)

P7

Nr.

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Udhëzime/Instructions:

1. MOS E HAPNI DERISA T'JU LEJOHET PREJ
MBIKËQYRËSIT
Do Not Open Until Your Invigilator Allows You to Do So.
2. ËSHTË E DETYRUESHME PËRGJIGJA E GJITHA
PYETJEVE
All Questions Are Mandatory
3. KOHA E LEJUAR ËSHTË 3 ORË
Time Allowed is 3 Hours
4. EMRI JUAJ NUK DUHET TË PARAQITET NË ASNJË
FLETË TË KËTIJ PROVIMI.
Your name should appear nowhere in this test

Data: 29.06.2019

Problemi 1

Kompania Biskotat Emergjente punon me kapacitet të plotë për të përmbushur kërkesat në rritje për produktet e saj. Për të rritur më tej kapacitetet e prodhimit, kompanië ka mundësi të marrë me lizing ambiente të reja të cilat do të duhet të mobilohen dhe pajisen nga fillimi me impiante prodhimi.

Lizingu do të kushtojë € 100,000 në vit, me pagesa të pagueshme në fund të vitit për të gjithë vitin dhe lizingu do të vazhdojë për pesë vjet me një normë fikse. Pajisja e re do të kushtojë € 850,000 dhe do të ketë një jetë të dobishme prej pesë vjetësh. Në fund të kësaj periudhe pritet që pajisja të ketë një vlerë të mbetur prej € 50,000. Vlerësohet se ambienti i ri i prodhimit do të mund të gjenerojë një kontribut shtesë prej € 250,000 në vitin e parë dhe € 350,000 për katër vitet e mëpasëm. Nuk do të ketë kosto fikse shtesë përveç qirasë së paguar si lizing.

Struktura e kapitalit të kompanisë është si më poshtë:

- 2.5 milion aksione të zakonshme me vlerë € 1 të cilat tani tregohen për € 1.15 pa dividend (ex div).
- 1 milion aksione preferenciale me vlerë nominale € 1 dhe interes 7% të cilat për momentin vlerësohen me 80 centë për aksion.
- 5,000 fletë - obligacione të siguruara jo të ri - bleshme me vlerë 12% dhe një vlerë nominale prej € 100 të cilat aktualisht vlerësohen me € 115 secila.
- 4,000 fletë - obligacione të siguruara të ri - bleshme me vlerë € 100 dhe interes 10% që do të duhet të ri - blihen pas katër vjetësh me një vlerë aktuale të tregut prej € 390,000.

Dividendët e paguar për vitin e fundit financiar ishin 10 centë për aksion por kjo pagesë pritet të rritet me 2% në vit në të ardhmen

Kërkohet:

- (a) Llogaritni koston mesatare të ponderuar të kapitalit. (10 pikë).**
- (b) Përcaktoni vlerën e tanishme neto të investimit të propozuar. Rekomandoni nëse propozimi duhet të pranohet apo jo dhe shpjegoni rregullat që keni ndjekur gjatë marrjes së këtij vendimi. Parashtroni supozimet që keni bërë në llogaritjet tuaja. (12 pikë)**
- (c) KMPK - ja është një metodë e përshtatshme për përcaktimin e koston të kapitalit dhe normës së skontimit që përdoret gjatë vlerësimit të investimeve në sektorin privat. Diskutoni se cilët janë faktorët që duhet të mbajë parasysh një organizatë jo - fitim - prurëse gjatë kohës kur përcakton normën e përshtatshme të skontimit. (3 pikë)**

Mos mbani parasysh tatimet në të gjitha llogaritjet

(Total = 25 pikë).

Problemi 1 (zgjidhjet)

(a)

KAPITALI EKUITAR DUKE PËRDORUR MODELIN E RITJES SË DIVIDENDËVE

$$r = [d_0(1 + g) \div MV] + g$$

Ku d_0 = dividendi

g = rritja

MV = vlera e tregut

$$r = [10(1 + 0.02) \div 115] + 0.02 = 10.87 \% \quad (2)$$

AKSIONET PREFERENCIALE

$$\text{Norma e kthimit} = 7 \div 80 \times 100 = 8.75 \% \quad (1)$$

FLETË - OBLIGACIONET E SIGURUARA JO TË RI - BLESHE

$$\text{Norma e kthimit} = 12 \div 115 \times 100 = 10.43 \% \quad (1)$$

FLETË - OBLIGACIONET E SIGURUARA TË RI - BLESHE

Norma e brendshme e kthimit nga rrjedhjet e parasë së gatshme në qoftë se borxhi blihet sipas vlerës aktuale të tregut. € 400,000 të ri - bleshme në katër vjet me interes 10 %.

VTN @ 10 %

$$= (390,000) + (40,000 \times 3.170) + (400,000 \times 0.6830) = € 10,000$$

VTN @ 12 %

$$= (390,000) + (40,000 \times 3.037) + (400,000 \times 0.6355) = (€ 14,320)$$

$$\text{NBK} = 10 \% + [10,000 \div (10,000 + 14,320) \times 12 \% - 10 \%] = 10.82 \% \quad (3)$$

KMPK

	Vlera e tregut (€ 000)	Kostoja	Kostoja e ponderuar
Aksionet e zakonshme	2,875	10.87 %	6.74 %
Aksionet preferenciale	800	8.75 %	1.51 %
Fletë - obligacionet e ri - bleshme	575	10.43 %	1.29 %
Fletë - obligacionet e ri - bleshme	390	10.82 %	0.91 %

Vlera e tregut (€ 000)	Kostoja Kostoja e ponderuar
4,640	10.45 %

KMPK = 10 % (e rrumbullakuar)

(3)

(b)

VTN:

	Viti 0 € 000	Viti 1 € 000	Viti 2 € 000	Viti 3 € 000	Viti 4 € 000	Viti 5 € 000
Pajisjet	(850)					50
Lizingu		(100)	(100)	(100)	(100)	(100)
Kontributi		250	350	350	350	350
Rrjedhjet neto të parasë së gatshme	(850)	150	250	250	250	300
FVT 10 %	1.000	0.9091	0.8264	0.7513	0.6830	0.6209
RrSP	(850)	136.365	206.600	187.825	170.750	186.27

VTN = € 37,810

Vini re se mund të ishte përdorur edhe faktori kumulativ i vlerës së tanishme për vitet 2 deri në 4 gjë e cila mund të kishte nxjerrë në pah një përgjigje të ndryshme nga ajo më sipër për shkak të diferencave të rrumbullakimit.

Propozimi duhet të pranohet meqenëse VTN – ja është pozitive. Rregulli për marrjen e vendimit bazohet mbi një shifrër pozitive e që demonstroi se norma e kthimit nga investimi i propozuar është më e madhe se kostoja e kapitalit që përdoret për të përcaktuar normën e skontimit.

Supozimet:

- Rrjedhjet e parave të gatshme do të jenë siç janë parashikuar.
- Kostoja e kapitalit është 10 % dhe nuk do të ndryshojë.
- Tatimet nuk janë marrë parasysh.
- Rrjedhjet e parave të gatshme ndodhin në fund të vitit.

(c)

Norma standarde e skontimit mund të caktohet nga qeveria qendrore ndërsa përdoret për të vlerësuar projektet e qeverisë qendrore dhe projektet e tjera të sektorit publik. Kjo normë është zakonisht një kosto nocionale e kapitalit e cila bazohet mbi Preferencën e Kohës Sociale e cila në vetvetë është një koncept ekonomik sipas të cilit shoqëria i jep vlerë konsumit të tashëm, dhe jo atij që do të ndodhë në të ardhmen. Kjo është një normë reale dhe nuk pasqyron rrezikun. Autoritetet publike mund të preferojnë të caktojnë normat e tyre oën duke u bazuar mbi kostot e tyre të huazimit (ose mesatare ose marxhinale). Në mënyrë alternative mund të specifikojnë një normë të veçantë të synuar ose të identifikojnë një normë të tillë e cila përfshin gjithashtu kostot oportune të fondeve që do të përdoren, bashkë me rreziqet që përmbajnë investimet përkatëse. Ndryshimi kryesor është që organizatat e sektorit publik nuk do të kenë asnjë shtysë që të gjenerojnë fitime dhe të maksimizojmë normat financiare të kthimit.

Problemi 2

Plakaruqi sh. p. k. po planifikon të rinovojë ambientet e tij ekzistuese dhe të ri – drejtojë biznesin e tij drejt një drejtimi të ri. Në të kaluarën, kompania, e cila ka si veprimtari palestrat sportive, fokusohet kryesisht mbi një qasje të bazuar vetëm mbi ushtrimet fizike dhe shumica e klientelës ishin meshkuj në moshë të re. Ndërsa kompania ka vënë në funksion një skemë të antarësimeve mujore, vetëm një pjesë e klientelës e respekton këtë skemë të pagesave – shumica e bazës së klientëve të kompanisë janë përdorues të rastësishëm të palestrës që paguajnë për ambientet vetëm në kohën që i përdorin ato. Plakaruqi ka punësuar kompaninë Plaku & Plakushja, një firmë që kryen hulumtime të tregut dhe këshillime të marrëdhënieve me publikun, në mënyrë që të ndihmojë me eksplorimin e tregjeve të reja.

Plakaruqi është duke marrë në konsideratë dy qasje alternative: e para synon të arrijë profesionistët e rinj të të dyja seksëve; ndërsa qasja e dytë fokusohet në krijimin e një ambienti familjar. Të dyja këto qasje do të kenë si bazë vetëm pagesën e një antarësie mujore dhe asnjë lloj tjetër pagese (pra njerëzit nuk do të mund të paguajnë vetëm një herë).

Plaku & Plakushja kanë përfunduar një vlerësim të kërkesës për të dy këto audiencë të synuara (pra, profesionistët e rinj dhe familjet). Plakaruqi do të duhet të përdorë këto të dhëna për të përpiluar një vlerësim të investimit duke u bazuar mbi vlerësimet e rrjedhjeve të ardhshme të parave të gatshme.

Rezultatet e punës së kompanisë së hulumtimit janë paraqitur në Tabelën 1, në formën e kërkesës së mundshme për dy tregjet e ndryshëm të synuar dhe të ndara sipas pikëpamjeve optimiste, neutrale ose pesimiste.

Tabela 1

Pikëpamja	Probabiliteti	VTN - Mundësia e profesionistëve të rinj € 000	VTN - Mundësia e ambienteve familjare € 000
Optimiste	0.2	750	1,100
Neutrale	0.4	600	650
Pesimiste	0.4	400	200

Kërkohet:

- Llogaritni vlerat e pritshme monetare të të dy mundësive dhe komentoni interpretimin e këtyre llogaritjeve. Qartësoni pozicionin e treguar me anë të shifrave për një organizatë neutrale ndaj rrezikut, një organizatë rrezik - urryese dhe një organizatë në ndjekje të rrezikut. (11 pikë).

- b) Rekomandojini Plakaruqit se cila nga të dyja mundësitë duhet të zgjidhet bashkë me kushtet nën të cilat duhet të pranohet mundësia në fjalë. (2 pikë)
- c) Përkufizoni rrezikun dhe pasigurinë. Shpjegoni arsyen se pse Plakaruqi e ka përfshirë rrezikun në llogaritë e tij gjatë vlerësimit të investimit. (3 pikë)
- d) Përshkruani shkurt mënyrën se si mund të përdoren analizat e ndjeshmërisë për të përfshirë rrezikun në vlerësimet e investimit. Sa e dobishme është analiza e ndjeshmërisë si një metodë që përdoret gjatë vlerësimit të rrezikut të projektit. (4 pikë)
- e) Diskutoni mënyrën se si mund të përdoret nga Plakaruqi teknika e simulimit gjatë vlerësimit të mundësive. (5 pikë)

(Total = 25 pikë).

Problemi 2 (zgjidhjet)

(a)

Vlera e pritshme monetare (VPM)

Probabiliteti	Mundësia e profesionistëve të rinj € 000	Mundësia e profesionistëve të rinj VEP € 000	Mundësia e ambienteve familjare € 000	Mundësia e ambienteve familjare VEP € 000
0.2	750	150	1,100	220
0.4	600	240	650	260
0.4	400	160	200	80
		550		560

Llogaritja e VPM – së tregon se mundësia e ambienteve familjare do të nxjerrë në pah një normë më të lartë të kthimit se sa mundësia e profesionistëve të rinj. Duhet të rikujtojmë se VPM – ja nuk është një shifër aktuale por bazohet mbi mesataret sipas probabiliteteve që i caktohen rezultateve të caktuara. Ajo është një bazë e cila përdoret nga marrësit e vendimeve që janë neutralë ndaj rrezikut. Në qoftë se marrësi i vendimit është rrezik - urryes ai duhet të marrë në konsideratë skenarin më të keq që mund të ndodhë i cili është ai që mundësia e ambienteve familjare të mund të realizojë një VTN prej vetëm € 200,000. Në këtë mënyrë ai do të zgjedhë mundësinë e profesionistëve të rinj. Nga ana tjetër një rrezik – kërkues do të favorizonte mundësinë e ambienteve familjare për shkak se ka një mundësi që të arrihet një VTN prej € 1,100,000.

(b)

Do të jetë e mundur të rekomandohet secila nga dy mundësitë. Përdorimi i thjeshtë i VPM – së do të bëjë që të rekomandohet mundësia e ambienteve familjare dhe kjo është në të njëjtën kohë edhe mundësia që ofron normëm më të madhe të mundshme të kthimit nëpërmjet VTN –së. Megjithatë, është e qartë se mundësia është shumë më e rrezikshme se sa mundësia e profesionistëve të rinj dhe për një shkallë të konsiderueshme. Përgjigja ndaj këtij seksioni do të duhet të parashtrojë qartë mundësitë e rekomanduara dhe të japë arsyet se pse.

(c)

Rreziku ka të bëjë me rezultatet e mundshme të një vendimi të veçantë ndaj të cilit mund të caktohen probabilitete. Në këtë mënyrë, rreziku mund të shprehet me terma sasiore.

Pasiguria nënkupton se nuk është plotësisht e mundur të identifikohen rezultatet ose të caktohen probabilitetet. Pasiguritë janë shumë të vështira për t'u parashikuar dhe shprehur me terma sasiore.

Plakaruqi ka përfshirë në llogari edhe rrezikun, për arsye se vlerësimi i investimit përfshin në vetvete shqyrtimin e gjërave që mund të ndodhin në të ardhmen dhe bërjen e gjykimeve dhe vlerësimeve për sa i takon rezultateve të mundshme. Nuk do të jetë reale të supozoni se gjykimet dhe vlerësimet të jenë gjithmonë tërësisht të sakta. Një supozim më i arsyeshëm është që ato do të jenë gjithmonë jo ashtu siç janë parashikuar.

(d)

Analizat e ndjeshmërisë janë një teknikë sipas të cilës secila mundësi e shqyrtuar gjatë marrjes së një vendimi testohet për cënueshmërinë e saj ndaj ndryshimeve në nivele të ndryshme të aktiviteve të tilla të ndryshueshme.

Analizat e ndjeshmërisë mund të jenë një metodë e dobishme që:

- Ndihmon me matjen e ndikimit të ndryshoreve individuale kundrejt rezultateve dhe vendimeve të parashikuara.
- Ofron më shumë informacione mbi të cilat mund të mbështeten gjykimet.
- Mund të përdoret vetëm për të shqyrtuar efektet që ka një ndryshore e vetme në një kohë të caktuar dhe nuk është kurrë kështu në botën reale për shkak se shumë ndryshore mund të ndryshojnë përnjëherësh.
- Ajo vlerëson vetëm ndikimin e rrezikut, dhe nuk shpreh në terma sasiore gjasat që një situatë e tillë të dalë faktikisht në pah.
- Llogaritjet dhe prezantimi i tyre “mund të jetë i ndërlikuar dhe i vështirë për t’u komunikuar ndaj marrësve të vendimeve.

(e)

Idea kryesore pas simulimit është krijimi i disa llojeve të modeleve duke u bazuar mbi supozimet e ndryshme, të zgjedhura rastësisht nga probabilitetet e përpiluara më parë. Fillimisht duhet të ndërtohet një model që tregon rezultat e projektit, duke pasur si të dhëna një bashkësi supozimesh që bazohen mbi vlerësimet më të mira. Këto supozime më pas ndryshohen rastësisht duke përdorur vlerat e zgjedhura me anë të probabiliteteve të paracaktuara.

Modeli ri – kryen llogaritjet duke përdorur secilin set të ri të vlerave dhe secili rezultat ruhet bashkë me të tjerët në mënyrë që të shihet shpërndarja e rezultateve të mundshme. Simulimi do të mund të zbatohet për vlerësimin e investimit të Plakaruqit, ku rezultati eventual do të jetë një tabelë që tregon një gamë të gjerë të vlerave të VTN - ve.

Modeli i simulimit mund të adoptohet për llogaritjen e niveleve të produkteve të ndryshme të tillë si pika rentabël për simulime të ndryshme ndërsa kostot e ndryshueshme, çmimet e shitjes dhe kostot fikse mund të parashikohen të gjitha dhe bashkë me pasiguritë që i bashkëngjiten atyre

Më pas mund të nxirren përfundime për sa i takon gamës së gjerë të rezultateve të mundshme dhe probabiliteteve të tyre përkatëse.

Problemi 3

(pjesa I)

'Ec në Këmbë' sh. p. k. prodhon biçikleta dhe departamenti i marketingut vlerëson se do të ketë një kërkesë konstante mujore prej 3,000 njësisish. Secila biçikletë përdor një frenë specifike të cilën 'Ec në Këmbë' e blen nga një furnitor me € 30 për njësi. Ky përbërës kërkon një farë kohe që nga koha kur jepet porosia deri kur merret malli në dorëzim dhe kjo zakonisht është 5 ditë pune. Kostot e porositjes janë vlerësuar si € 10 për porosi dhe kostot e mbajtjes së këtij artikulli janë vlerësuar të jenë sa 10% e vlerës së një frene në vit. Kompania mban stoqe rezervë në nivele sigurie dhe çdo muaj punohet vetëm për 20 ditë pune.

Kërkohet:

- a) **Llogaritni (6 pikë)**
 - i. **Modelin e sasisë së porosisë ekonomike**
 - ii. **Numrin e porosive të kërkuara në një vit**
 - iii. **Kostot totale të porositjes dhe mbajtjes së këtij përbërësi në një vit**
- b) **Duke supozuar se nuk ka stoqe rezervë në nivele sigurie dhe se niveli aktual i stoqeve është 900 përbërës, kur duhet të jepet porosia tjetër? (2 pikë)**
- c) **Diskutoni problemet me të cilat mund të përballohet kjo firmë po qe se përpiqet të zbatojë në praktikë këtë model të kontrollit të stoqeve. (4 pikë)**

(pjesa II)

Spitali Këlcyra ka hyrë në një partneritet me Këshilli Komunar Spille për sa i takon ofrimin të pajisjeve mjekësore për njerëzit që kanë probleme sociale dhe shëndetësore. Është themeluar një Magazinë e Përbashkët për Pajisje (MPP) (në të cilën Këlcyra është partneri kryesor), dhe e cila ofron një gamë të gjerë të pajisjeve përfshirë karrocet me rrota për invalidë.

Menaxheri i magazinës është i shqetësuar për sa i takon kërkesës në rritje për pajisje, e kombinuar kjo me mungesën e hapësirës për magazinim. Në të njëjtën kohë, pas bërjes së një krahasimi me një pikë të referimit [bençmarking] me një sipërmarrje të ngjashme të pabashkët, doli në pah se kostot e ruajtjes dhe magazinimit në MPP janë më të larta se organizatat e krahasueshme.

Është sugjeruar krijimi i një skeme pilot për të hetuar përdorimin e modelit të sasisë së porosisë ekonomike (SPE / EOQ) si një metodë e porositjes së pajisjeve për vitin e ardhëshëm në mënyrë që të mund të adresohen çështjet që kanë të bëjnë me hapësirën për magazinim dhe kostot përkatëse. Për të provuar se si do të shkojë puna, është marrë vendimi që modeli të zbatohet sa për provë për karrocet standarde me rrota për invalidë.

Të dhënat për përdorimin e karrocave të reja standarde me rrota për invalidë janë përfutur nga sistemet e kompjuterizuara të magazinimit sipas blerjeve të bëra gjatë tre viteve të kaluara.

Viti aktual	Një vit më parë	Dy vjet më parë
260	226	199

Duke u bazuar mbi të dhënat demografike supozohet se numri i karrocave të reja me rrota për invalidë që do të kërkohet të blihen vitin e ardhshëm do të rritet dy herë sa përqindja e rritjes nga viti i kaluar në vitin aktual. Koha që kalon nga dita kur jepet porosia deri kur ajo merret në dorëzim është pak a shumë 10 ditë pune për karrocet me rrota për invalidë (le të supozojmë 250 ditë pune në vit). Kostot e mbajtjes së stoqeve janë llogaritur si më poshtë: € 8 për 10 karroca me rrota për invalidë, në një vit. Secila porosi kushton € 30 (pavarësisht prej sasisë).

Kërkohet:

- (a) Shpjegoni çfarë synon të arrijë modeli SPE/EOQ dhe cilat janë supozimet e tij kryesore. (4)
- (b) Llogaritni SPE/EOQ për porositë e karrocave me rrota për invalidë për vitin e ardhshëm për MPP dhe kostot totale që kanë të bëjnë me kostot e porositjes dhe ruajtjes së stoqeve të tilla. (6)
- (c) Përshkruani të gjitha kufizimet që dalin në pah nga përdorimi i modelit SPE/EOQ në këtë rast. (3)

(Total I+II = 25 pikë).

Problemi 3 (zgjidhjet)

PJESA I

(a)

$$(i) \quad \text{SPE / EOQ} = \sqrt{(2 \times 36,000 \times \text{€ } 10 \div \text{€ } 3)} = 489.90$$

$$(ii) \quad \text{Porosia mesatare në vit} = 36,000 \div 489.90 = 73.48$$

$$(iii) \quad \text{Kostoja mesatare për porosi} = 73.48 \times \text{€ } 10 = \text{€ } 734.80$$

$$\text{Kostoja mesatare vjetore e mbajtjes së stoqeve} = (489.90 \div 2) \times \text{€ } 3 = \text{€ } 734.85$$

$$\text{Kostot totale në vit} = \text{€ } 1,469.65$$

(b) Përdorimi në një ditë pune = $36,000 \div 240 = 150$ në ditë 900 përbërës janë në këtë mënyrë stoqe për 6 ditë

Meqenëse koha që kalon derisa të merret në dorëzim porosia është 5 ditë, do të duhet të jepet një porosi që të nesërmen.

(c) Le të supozojmë se kostoja e porositjes dhe kostoja e mbajtjes do të jenë konstante – me mundësi të madhe në praktikë nuk ndodh kurrë kështu ndërsa në të njëjtën kohë është e vështirë të vlerësohen kostot në fjalë me saktësi të arsyeshme.

Shitjet vjetore nuk do të jenë të njëtrajtshme për shkak të sezonalitetit të kërkesës për biçikleta për Krishtlindje dhe në verë. Në këtë mënyrë stoqet rezervë në nivele sigurie do të duhet të ndryshojnë.

Çmimet e blerjes mund të jenë më të ulëta në rastet kur porositen sasi më të mëdha.

A është gjithmonë furnitori i aftë të dorëzojë një porosi të dhënë brenda 5 ditëve?

PJESA II

(a)

Modeli i sasisë së porosisë ekonomike (SPE / EOQ) është një model i zhvilluar për të përcaktuar madhësinë optimale të porosive që do të jepen (duke u përpjekur të reduktohen kostot totale të stoqeve). Në të njëjtën kohë ai përcakton madhësinë dhe numrin e porosive që duhet të jepen, frekuencën (shpeshësinë) e porosive dhe koston e përgjithshme të procesit të menaxhimit të stoqeve.

Supozimet kryesore janë:

- Dihet kërkesa për secilin artikull të stoqeve.
- Ka një përdorim të njëtrajtshëm [konsistent] të stoqeve gjatë gjithë periudhës, kjo do të thotë që kemi të bëjmë me një funksion linear.
- Sasia e porositur nuk ndryshon me kalimin e kohës.
- Kostoja e porositjes për secilin zë mund të vlerësohet dhe mbetet konstante.
- Ndryshoret e tjera janë fikse dhe nuk ndryshojnë me kalimin e kohës.
- Ri - porositja e stoqeve bëhet menjëherë, sapo niveli i stoqeve arrin zeron.

- Ka vetëm dy lloje të kostove, të cilat duhet të mbahen parasysh: kostot e mbajtjes dhe kostot e porositjes.

(b)

Në këtë rast është supozuar se numri i karrocave të reja me rrota për invalidë të kërkuara gjatë vitit të ardhshëm do të rritet me një përqindje dy herë më të madhe se sa përqindja e rritjes nga viti i kaluar tek viti aktual. Rritja nga viti i kaluar në këtë vit është $(260 \div 226) - 1 = 15\%$. Në këtë mënyrë, dyfishi i nivelit të rritjes është 30%, e cila është $260 \times 1.3 = 338$ njësi.

Formula për SPE / EOQ është si më poshtë:

$$\sqrt{(2CD \div H)}$$

ku:

C është kostoja e dhënies së një porosie

D është numri i njërive që përdoren gjatë një viti (kërkesa)

H është kostoja e mbajtjes së një njësie për një vit.

$$= \sqrt{(2 \times 30 \times 338 \div 0.8)}$$

= 159.2 të themi 160 (karroca me rrota për invalidë) ose = 159.2 të themi 159 (karroca me rrota për invalidë)

Numri i porosive të kërkuara është $338 \div 160 = 2.11$ në vit (*kjo mund të rrumbullakohet në 2 porosi ose deri në 3 porosi ndërsa ka ndikim mbi llogaritjet e mëpasme*)

ose

Numri i porosive të kërkuara është $338 \div 159 = 2.12$ në vit (*kjo mund të rrumbullakohet në 2 porosi ose deri në 3 porosi ndërsa ka ndikim mbi llogaritjet e mëpasme*)

Kostot e porositjes = € 30 x 2.11 = € 63.30 1 pikë

Kostot e mbajtjes së stoqeve = $160 \div 2 \times € 0.80 = € 64$ 2 pikë

Kostoja totale vjetore = € 63.30 + € 64 = € 127.30 1 pikë

(c)

Një nga problemet me modelin SPE / EOQ është që ai supozon se kërkesa për artikujt e stoqeve është konstante. Nuk e dimë nëse kjo është e vërtetë në këtë rast.

Në të njëjtën kohë modeli supozon se stoqet mund të bien në nivelin zero pa pasur ndikime negative për organizatën, gjë që nuk ka edhe shumë gjasa të jetë e vërtetë në këtë rast.

Gjithashtu modeli supozon se nuk do të ketë vonesa midis kohës kur jepet porosia dhe kohës kur ajo merret në dorëzim. Ky supozim nuk është fare pranë realitetit.

Disa nga karrocet me rrota për invalidë mund të përdoren përkohësisht, të kthehen në magazinë dhe të përdoren përsëri nga dikush tjetër. Llogaritjet e kostove të mbajtjes së stoqeve nuk e mbajnë parasysh këtë element.

Problemi 4

Unversiteti i Qypave është duke planifikuar aktivitetet e tij të menaxhimit të parasë së gatshme për vitin e ardhshëm financiar. Në të njëjtën kohë menaxhmenti është i shqetësuar për sa i takon besueshmërisë së parashikimeve që tregojnë tepricat e parasë së gatshme, të cilat do të jenë në dispozicion të organizatës. Vlerësohet se kërkesa totale për para të gatshme në vitin e ardhshëm do të jetë € 350 milion. Kostoja e tërheqjes së parave të gatshme nga investimi është vlerësuar të jetë € 250 për secilin transaksion. Normat e interesit për investimet afat - shkurtra janë 7%.

Kërkohet:

- a) Duke përdorur Modelin Baumol, llogaritni: (9 pikë)
- i. Sasinë optimale të parasë së gatshme që duhet të tërhiqet nga investimet sa herë që teprica e parasë së gatshme bëhet zero;
 - ii. Numrin e tërheqjeve çdo vit;
 - iii. Tepricën mesatare të parave të gatshme; dhe
 - iv. Kostot totale të menaxhimit të parasë së gatshme.
- b) Krahasoni dhe tregoni ndryshimet midis modelit Baumol dhe modelit Miller - Orr (nuk iu kërkohet të bëni llogaritje). (8 pikë)
- c) Duke përdorur modelin Miller - Orr, llogaritni balancën e synuar dhe kufirin maksimal të parave të gatshme, në qoftë se: (8 pikë)
- Varianca e rrjedhjeve ditore të parave të gatshme = € 750,000²
 - Kostot e transaksioneve = € 250 për transaksion
 - Kufiri i poshtëm [minimal] i parasë së gatshme = € 150,000
 - Kostot ditore oportune të parasë së gatshme = 0.02%

(Totali = 25 pikë)

Zgjidhje e problemit - 4

(a)

$$(i) C = \sqrt{\frac{2bt}{i}}$$

$$C = \sqrt{\frac{2 \times 350,000,000 \times 250}{0.07}}$$

$$C = \text{€ } 1,581,139$$

(ii) Numri i transaksioneve të shndërrimit në para të gatshme çdo vit:

$$= \text{€ } 350,000,000 \div \text{€ } 1,581,139 = 221$$

(iii) Teprica mesatare e parave të gatshme = $C \div 2$ (ku C është injektimi optimal i parasë së gatshme nga (i) më sipër)

$$= \text{€ } 1,581,139 \div 2$$

$$= \text{€ } 790,570$$

(iv) Kostot totale = $(\text{€ } 250 \times 221) + (\text{€ } 790,570 \times 0.07)$

$$= \text{€ } 110,590$$

(b)

Modeli Baumol i menaxhimit të parave të gatshme krijon një analogji midis menaxhimit të parave të gatshme dhe menaxhimit të përgjithshëm, ndërsa zbaton modelin e sasisë së porosisë ekonomike edhe për menaxhimin e parasë së gatshme. Ky model, përdoret për të gjetur rrjedhjet e parave të gatshme, të cilat do të minimizonin kostot totale të mbajtjes së fondeve në dorë. Modeli bazohet mbi supozimin se ekziston një mjedis i gjendjes së qëndrueshme, në të cilin rrjedhjet e parasë së gatshme janë të sigurta dhe konstante [të pandryshueshme]. Gjithashtu edhe daljet e parave të gatshme, ndodhin para se të ndodhin arkëtimet dhe janë të vazhdueshme dhe ndodhin me një normë konstante para se rezerva e parave të konsumohet plotësisht. Letrat e tregtueshme me vlerë përjashtohen nga ky model: ato shiten për të krijuar një tepricë të parasë së gatshme që mund të përdoret për të përmbushur transaksione sa herë që është e nevojshme.

Modeli Baumol supozon, me një thjeshtësi disi të tepruar se edhe hyrjet e parave të gatshme janë të rregullta dhe periodike. Ky supozim është i vlefshëm për këtë rast, në qoftë se të gjitha hyrjet e parasë së gatshme, përfshirë të ardhurat nga shitja e letrave të tregtueshme me vlerë, ndodhin në ditën e parë të secilit muaj. Këto 'stoqe' të parasë së gatshme më pas konsumohen me një normë konstante gjatë muajit ndërsa llogaria bankare rimbushet plotësisht dhe menjëherë vetëm në fund të muajit.

Modeli Miller - Orr përfaqëson një qasje më të sofistikuar dhe realiste ndaj menaxhimit të parasë së gatshme. Ai lejon që rrjedhjet neto të parasë së gatshme, të ndodhin sipas karakteristikave të çfarëdoshme, ndërsa ndryshimet janë të rastësishme dhe të

parashikueshme. Modeli në fjalë i kapërcen supozimet e thjeshtëzuara të qënies konstante dhe sigurisë së kërkesës që përmban Modeli Baumol.

Ky model, zgjeron edhe më tej modelin e kontrollit të menaxhmentit, duke vënë në funksion disa kufij të zakonshëm të kontrolleve: modeli krijon krijimin e kufijve të sipërm dhe të poshtëm të kontrollit, brenda të cilëve lejohet të luhatet teprica ditore e parasë së gatshme. Në qoftë se teprica ditore e parasë së gatshme arrin kufirin e sipërm të kontrollit, duhet që para e gatshme do të përdoret për të blerë letra të tregtueshme me vlerë. Shuma monetare që do të përdoret për të blerë letra të tregtueshme me vlerë përcaktohet si diferenca midis kufirit të sipërm të kontrollit dhe nivelit të synuar të parasë së gatshme. E anasjellta, në kohën kur arrihet kufiri i ulët [minimal], kërkohet një injektim [futje] e parave të gatshme, e cila e kthen tepricën në nivelin e synuar.

Në praktikë Modeli Baumol ofron një pikë të dobishme të nisjes që mundëson zhvillimin e metodave më realiste të menaxhimit të parave të gatshme. Ai mund të modifikohet për të përfshirë deri në një nivel të caktuar edhe pasiguritë, duke vendosur një nivel të 'stoqeve rezervë në nivel sigurie' për paranë e gatshme për qëllime transaksionesh. Megjithatë, është e qartë se Modeli Baumol nuk është i përshatshëm në kohën kur pasiguritë dhe parregullsitë e rrjedheve të parave të gatshme janë një karakteristikë e përhershme.

(c)

$$\begin{aligned} Z &= \sqrt[3]{\frac{3F\sigma^2}{4K}} + L \\ &= \sqrt[3]{\frac{3 \times 250 \times 750000^2}{4 \times 0.0002}} + 150,000 \\ &= \text{€ } 957,913 \end{aligned}$$

$$\begin{aligned} H &= 3Z - 2L \\ &= 3 \times 957,913 - 2 \times 150,000 \\ &= \text{€ } 2,573,739 \end{aligned}$$